

LIGJ
Nr.8334, datë 23.4.1998

PËR PRIVATIZIMIN E SHOQËRIVE TREGTARE QË VEPROJNË NË
SEKTORËT JOSTRATEGJIK

(Ndryshuar me Aktin Normativ nr. 4, datë 4.4.2002; nr. 8886, datë 22.4.2002; nr. 9274, datë 16.9.2004)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Përkufizime

(Ndryshuar togfjalësh me Aktin Normativ nr. 4, datë 4.4.2002; shtuar paragrafi i fundit me ligjin nr. 9274, datë 16.9.2004)

Në kuptim të këtij ligji:

Paketë aksionesh të shoqërive tregtare ose ofertë për privatizim është kuota e aksioneve, që shteti si pronar i vetëm, i përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë shpall për privatizim.

Kërkesë është vleftha në lekë, lekë ose bono privatizimi, që investohen për të blerë aksione në shoqëritë tregtare që privatizohen.

Kapitali themeltar është kapitali i shoqërisë që figuron në vendimin e gjykatës për regjistrimin e saj si person juridik. Vlera e trullit, brenda kufijve të shoqërisë është pjesë e pandarë e këtij kapitali.

Formula e privatizimit është ndarja e aksioneve të shoqërisë në:

Paketë aksionesh është paketa e aksioneve që i ofrohet blerësit.

Kjo paketë shitet me lekë.

Paketa e aksioneve për ish-pronarin e trullit është pjesa e aksioneve me të cilat ish-pronari i trullit hyn në shoqërinë tregtare pa pjesëmarrjen në ankand.

Ish-pronarët e trullit si subjekte kërkuese kanë të drejtë të marrin aksione në përpjestim me vlerën e trullit të njohur, në bazë të vendimit të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Vlera e trullit përcaktohet sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kompensimi në përqindje, i caktuar në raport me pjesën tjetër të kapitalit të shoqërisë, mbetet i pandryshuar, pavarësisht nga rezultatet e ankandit.

Paketa e aksioneve për publikun është pjesa e aksioneve që i ofrohet publikut dhe punonjësve të shoqërisë në këmbim të bonove dhe lekëve të privatizimit. Punonjësit e shoqërisë kanë të drejtë të shkëmbejnë me vlerë nominale bonot e tyre dhe ato të familjes me aksione të shoqërisë.

Punonjës të shoqërisë konsiderohen punonjësit aktualë dhe ata të trajtuar me

asistencë sipas ligjit nr.7521, datë 30.10.1991 " Për përkrahjen sociale për personat që dalin pa punë nga zbatimi i reformës ekonomike", një vit para publikimit të shoqërisë për privatizim.

Paketa e aksioneve shtetërore është pjesa e aksioneve që mbahen nga shteti.

Këshilli i Ministrave mund të vendosë shitjen e paketës së aksioneve për ish-të përndjekurit politikë, brenda strukturës së formulës së privatizimit. Kjo paketë shitet me ankand, me bono dhe lekë privatizimi.

Neni 2

(Ndryshuar togfjalësh me Aktin Normativ nr. 4, datë 4.4 2002)

Ministria e Ekonomisë përcakton formulën e privatizimit pas përcaktimit të pjesës së aksioneve për ish-pronarët e truallit dhe punonjësit e shoqërisë dhe, së bashku me dokumentacionin përkatës të shoqërive, i vë në dispozicion të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit.

Neni 3

Forma e privatizimit të paketave të aksioneve të shoqërive tregtare është ankandi, i cili organizohet nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit.

Në raste të veçanta Këshilli i Ministrave cakton si formë privatizimi tenderin dhe, në përfundim të tij, vendos për privatizimin e paketës së aksioneve.

Neni 4

Privatizimi për paketat e aksioneve të shoqërive tregtare, nëpërmjet ankandit, zbatohet fillimisht për paketën që i ofrohet blerësit.

Neni 5

(Ndryshuar togfjalësh me Aktin Normativ nr. 4, datë 4.4 2002)

Nga të ardhurat e shitjes së paketës së aksioneve përfitojnë:

- Agjencia Kombëtare e Privatizimit 5 për qind të vlefës fillestare të shpallur. Kjo vlefë kalon në degën e thesarit për llogari të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit.

Ministria e Ekonomisë 20 për qind të vlerës së shitjes, për fond zhvillimi të ndërmarrjeve dhe shoqërive tregtare shtetërore. Kriteret e administrimit dhe përdorimit do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave

Diferenea e vlerës së shitjes kalon në buxhetin e shtetit.

Neni 6

(Ndryshuar togfjalësh me Aktin Normativ nr. 4, datë 4.4 2002)

Për zbatimin e këtij ligji ngarkohet Ministria e Ekonomisë.

Neni 7

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet e nevojshme nënligjore.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2082, datë 8.5.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani